V E N D I M
Nr.5, datë 13.04.1993

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë e përbërë nga:

Rustem Gjata,	Kryetar,	i Gjykatës Kushtetuese
Feti Gjilani,	Zv/Kryetar	i Gjykatës Kushtetuese
Manol Konomi,	Anëtar i	""
Hilmi Dakli,	Anëtar i	""
Veli Budo,	Anëtar i	""
Franc Jakova	Anëtar i	""
Thimjo Kondi,	Anëtar i	""
Ylvi Myrtja,	Anëtar i	""
Natasha Sheshi,	Anëtar i	""

Me sekretare Drita Filto më datën 13.4.1993, shqyrtoi në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr.6 Akti, që i përket:

KËRKUES: GJYKATA E RRETHIT TIRANE

O B J E K T I

Interpretimi i ligjit Nr.7521, datë 30.10.1991 "Për përkrahjen sociale për personat që dalin të papunë nga zbatimi i reformës ekonomike".

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relacionin përkatës,

V Ë R E N:

Gjykata e rrethit Tiranë, me vendimin e saj të ndërmjetshëm datë 23.02.1993, ka pezulluar çështjen që i përket Shpresa Bakallit kundër Kombinatit të Tekstileve Tiranë, me objekt dhënie asistence. Sipas kësaj gjykate,çështja si më sipër nuk mund të zgjidhet pa u bërë më parë nga ana e Gjykatës Kushtetuese interpretimi i Ligjit Nr.7521, datë 30.10.1991 "Për përkrahjen sociale për personat që dalin të papunë nga zbatimi i reformës ekonomike", ndryshuar më vonë me Ligjin Nr.7579, datë 02.07.1992.

Sipas nenit 24/1 të Ligjit Nr.7561, datë 29.04.1992 "Për disa ndryshime e plotësime në Ligjin Nr.7491, datë 29.04.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese", Gjykata Kushtetuese bën interpretimin e kushtetutës dhe të ligjeve kushtetuese, e nuk është kompetente të bëjë interpretimin e ligjeve të zakonshme.

Interpretimi i dispozitave ligjore bëhet nga organi gjatë shqyrtimit dhe zgjidhjes konkrete.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në bazë të nenit 24 të ligjit nr.7561, datë 29.4.1992 "Për disa ndryshime e plotësime në ligjin nr.7491, datë 29.4.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese",

V E N D O S I:

Deklarimin e inkompetencës së Gjykatës Kushtetuese për shqyrtimin e çështjes.

Ky vendim është përfundimtar dhe I formës së prerë.

Tiranë më 13.4.1993